Aktualitet

# Kamëz, pronari i lokalit plagosi klientin, në pranga një 35-vjeçar

*Pronari i një lokali në Kamëz u arrestua pas qëlloi me armë zjarri një prej klientëve të tij pas një konflikti të çastit. Ngjarja ndodhi rreth orës 02:00 të natës në Kodër Kamëz.*

Redaksia
17 Shtator, 10:49 | Përditësimi i fundit: 17 Shtator, 10:58

Share 7 Tweet

Pronari i një lokali në Kamëz u arrestua pas qëlloi me armë zjarri një prej klientëve të tij pas një konflikti të çastit.

Ngjarja ndodhi orët e para të mëngjesit të së enjtes rreth orës 02:20 në Kodër Kamëz.

LEXO EDHE:
**Prishi qetësinë publike dhe kanosi me thikë pronarin e lokalit, arrestohet algjeriani në 'ish Bllok'**

Bashkëpronari i lokalit, shtetasi me iniciale F.K., 35 vjeç banues në Tiranë u përfshi në një konflikt fizik me 39-vjeçarin me iniciale R.C. për motive të dobëta.

Konflikti më pas vijoi jashtë ambienteve të lokalit ku pronari qëlloi me armë drejt klientit duke e plagosur.

Më pas ai tentoi që ta qëllojë sërish por ndërhyrja e policisë parandaloi përshkallëzimin e konfliktit.

"Bashkëpronari i lokalit, shtetasi F. K., 35 vjeç, banues në Tiranë, në brendësi të lokalit është përfshirë në një konflikt fizik e verbal për motive të dobëta, me shtetasin R. C. (klient lokali) dhe më pas konflikti ka vijuar në ambientet e jashtme të lokalit. Si pasojë e konfliktit shtetasi F. K. ka plagosur me armë zjarri në dorë, shtetasi R. C., 39 vjeç., i cili u dërgua në spital dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën" - njofton policia.

Ata arrestuan pronarin e lokalit dhe i sekuestruan armën.

Materialet hetimore në lidhje me këtë ngjarje i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vrasja, e mbetur në tentativë" dhe "Armëmbajtja pa leje"

E.D./Shqiptarja.com

TAG: plagosje me arme zjarri | kamez | lokal

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
A po zbatohen masat anti-Covid në shkolla?
Po | Jo | Nuk e di
Komento

Lajme të tjera

Aktualitet

Shkop bejsbolli, karrige...çfarë ka mbetur pas sherrit në Durrës
18 Shtator, 21:40

Aktualitet

Digjet një 'Mercedes Benz' në Elbasan, shkak defekti në makinë (FOTO)
18 Shtator, 21:33

Aktualitet

U plagos pas një sherri në Durrës, ndërron jetë një nga të plagosurit
18 Shtator, 21:20

Aktualitet

Humb kontrollin e 'Benz'-it e përfundon në dyqanin ushqimor, 23-vjeçari shoqërohet në komisariat
18 Shtator, 21:16

Aktualitet

Kontrollet e policisë në Berat, arrestohen 5 persona e vihen në hetim 1 tjetër
18 Shtator, 21:02

Aktualitet

Bollino: Miliona e miliona lekë nga 'oligarkët' ndaj dy familjeve në PD dhe mediave të saj
18 Shtator, 20:37

MINUTË PAS MINUTE
21:46 Policia e Durrësit jep njoftim zyrtar për vrasjen në Durrës: Në spital një tjetër i plagosur, s'dihet nëse ka lidhje me ngjarjen
21:40 Shkop bejsbolli, karrige...çfarë ka mbetur pas sherrit në Durrës
21:36 Digjet një 'Mercedes Benz' në Elbasan, shkak defekti në makinë (FOTO)
21:21 U plagos pas një sherri në Durrës, ndërron jetë një nga të plagosurit
21:20 Humb kontrollin e 'Benz'-it e përfundon në dyqanin ushqimor, 23-vjeçari shoqërohet në komisariat

Me te lexuarat e dites | Me te lexuarat e javes
Lajme | Fotogaleri | Videogaleri
1. 'Me filxhan kafeje në dorë, më pas i shtrirë përtokë', momenti i ekzekutimit të Bujar Çelës (FOTO)
2. I mbijetoi atentatit me tritol, Preng Gjini flet nga spitali: Nuk jam në hasmëri dhe nuk ruhesha! S'mbaj përgjegjësi për veprimet e vëllai
3. 'Ligji për presidentin', Meta kërcënon me shpërndarjen e parlamentit: Po deshën le ta provojnë, të mos dinë ku të futen! S'më frikëson asnjë i marrosur
4. A do të jetë Sali Berisha kandidat për deputet? Basha nuk mendohet dy herë: Po, do garojë ku të dojë ai (VIDEO)
5. Jep dorëheqjen sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, Plarent Ndreca
6. 'Berisha të kandidojë ku të dojë', Braçe ironizon: Saliu do ishte i denjë për deputet në Gërdec ose Bulevard
7. Jep dorëheqjen zv.drejtori i Policisë së Tiranës
8. Ekskluzive/Fushata e sulmeve të Berishës ndaj Azem Hajdarit në dhjetor '96, akuzat dhe diversionet përmes RD-sé, kërcënimet deri në përjashtim nga PD
9. Këshilli politik, palët dalin më të përçara se kurrë! Bylykbashi: Presim përgjigjen e Gjiknurit për ODIHR! Hajdari: Propozimi i PS nuk hap listat!
10. 'Ligji për presidentin' Meta kërcënon me shpërndarjen e parlamentit: Po deshën le ta provojnë, të mos dinë ku të futen! S'më frikson asnjë i marrosur



© 2011 - 2020 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje